

RUDI I. SPAHIU

ORTEKU

BIBLIOTEKA
SHITETIT

854-32

S 81

ORTEKU

TREGIME

89/583-32

581


S

RUDI I. SPAHIU

ORTEKU

(Tregime)

~~56006~~



2309

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

SHOKËT

— Haki, po ti qenke kokëfortë! A s'të thashë një herë të heqësh dorë nga krijimi yt! S'bën dot kopiatrice ti! — i tha brigadieri.

Hakiu e vështroi duke përmbajtur veten nga tronditja që i shkaktuan fjalët e Zenelit; dhe nuk u përgjegj. Sytë ju picërruan fare.

— S'do ta lë punën, pa e parë se deri ku kam arritur.

— More, ç'më duhet mua se deri ku ke arritur ti!

Ata përsëri, si ditët e tjera, bisedonin me zë të lartë, pa u marrë vesh midis tyre. Dhe përsëri pranë tyre u afruan punëtorët.

— Hakiu për të mirën e përgjithshme po punon, shoku brigadier, ai s'po e bën maqinën për babanë e tij — tha njëri prej tyre.

— E di që s'e bën për vete, por unë kam frikë se mos rrahim ujë në havan. U bënë kaq ditë që merret me të... Po, në qoftë se ju ngulni këmbë, atëhere edhe unë tërhiqem.

Hakiut, sa dëgjoi shokët, ju çel fytyra, hodhi cigaren dhe i falënderoi, pastaj ju afrua kopiatrice-

çes, që do të bënte kallëpe për këpucë. Ai i vështroi shokët përsëri dhe u buzëqeshi.

Afërditën as që e vuri re fare. Vajza u habit, se ishte mësuar që ai t'i buzëqeshte gjithnjë. Kur e shikonte që larg, i tundte dorën e tij të madhe; kësaj radhe ndodhi ndryshe. «Ai s'pyeti për mua!» mendoi Dita. Shkoi kokëvarur në tornon e saj dhe zuri të punonte.

Hakui përveshi mëngët e këmishës dhe nxori krahët tërë muskuj. Si shtrëngoi copën e metalit, mori limën dhe zuri të limonte. Balli ju mbush me djersë. Ngriti kokën dhe e fshiu ballin me shpinën e dorës, pa e lëshuar limën. Në fytyrë i mbetën vijëza ngjyrë sërmë. Kur ra sinjali për pushim, punëtorët lanë punën dhe shkuan të hanin darkë. I kaluan pranë Hakikut. Fatriu i rrahu shpatullat dhe i tha: «S'ta kalon dot njeri si axhustator, Haki, s'ta ha qeni shkopin». Afërdita i shkoi pranë dhe s'i foli. Hakui, që kishte ngritur kokën dhe po u buzëqeshte shokëve, u habit për qëndrimin e Ditës.

«Për sonte mjaft» tha ai me vete dhe doli jashtë. Retë si shtëllunga tymi qarkonin hënën. Hakui eci dhe u kënaq nga freskia e mbrëmjes, nga fëshfëritja e gjetheve të plepit.

Të nesërmen Hakui po përgatitej të fillonte montimin e maqinës. Një ankth i brendshëm po ja dobësonte fuqitë. Shkaku i kësaj plogështie s'dihej se ku e kishte burimin, mbase i ndodhte ngaqë punonte vetëm, pa i rrahur mendimet me shokët. «Çudi, mendoi, kjo gjë s'më ka shkruar në mendje; pa dale një herë, po, kjo është e drejtë...» Pastaj u kthye vrik nga maqina.

Hakui kishte nisur nga montimi i maqinës. Pu-

nëtorët punonin dhe, po t'i shikoje, të dukej sikur s'e vrisnin fare mendjen për punën që po bënte Hakiu. Vetëm Dita ngriti kokën dhe shikonte kopia-triçen, që po merrte formë. Ajo fshiu fytyrën me pëllëmbën e dorës dhe shuajti tornon. Dita, pa i mbajtur fare mëri që Hakiu s'i foli ditën e shkuar, ju afrua e drojtur. Ai s'e dëgjoji kur i tha: «Punë të mbarë, Haki!» Ai kishte ulur kokën dhe po shtrëngonte një vidhë.

— Ah, ti qenke Dita! — tha ai pas pak.

— Po — i tha ajo — unë të fola, po ti s'e kishe mendjen fare.

— Më fal, s'të vura re! Po ç'kemi?

Ajo qeshi, ngriti pakëz shaminë e kokës dhe zbuloi ballin e saj të djersitur.

— Ti u lodhe, Haki!

— Jo s'u lodha, por kam një si shqetësim, se çfarë, s'di si ta përcaktoj.

— Po çfarë ke, ma thuaj mua, — e në çast asaj i ra inati që kishte marrë ditën e shkuar me Hakiun — hë pra, folë!

— Po s'kam ç'të them, s'di si ta përcaktoj, mbase nga puna që kam nisur. E kupton, jam në pritje — i tha Hakiu me dashamirësi.

— Mos u nxito që ta mbarosh për tri ditë. Shokët i thanë Zenelit për inisiativën tënde.

— Ke të drejtë, Dita, shokët s'u kursyen për mua, po unë kam hall se mos turpërohem!

Ajo qeshi.

— Ti kurrë s'do të turpërohesh, unë i njoh forcat e tua.

Hakiu e vështroi Ditën, po s'foli, sikur t'i kishte mbetur diç në grykë. Po afroheshin edhe punëtorë

të tjerë rreth tyre. Maqina u ngrit dhe Hakiu me nxitim mori dy copa druri pa formë dhe, me duar të dredhura, i kapi nga të dy anët me mashë, kurse lart vuri kallëpin origjinal me numër dyzet. Si i kreu të gjitha këto punë, fshiu buzët, dhe u dha flokëve prapa si t'i kishin zënë sytë. Ndezi motorin. Motori në fillim u lëkund si të zgjohej nga një gjumë i rëndë, por në çast mori shpejtësinë. Hakiu lëvizi levën dhe të dyja thikat u lëshuan në dy copëzat e drurit. Atij nisën t'i visheshin sytë me një perde si të murme, kur pa se ato s'po vepronin ashtu si kishte menduar më përpara. Ai në çast u drodh e i shkuan mornica. Ashklat e drurit mbuluan maqinën, derisa u rrafshuan dy copëzat e drurit. Ai shoi motorin dhe i verdhë dyllë në fytyrë, vuri të dy duart në mes.

— Unë s'vlekam asnjë grosh! — u tha shokëve. Patriu ju afrua dhe i hodhi dorën në sup. Një shok tjetër i tha se këto punë nuk zgjidheshin ashtu fët e fët. Shokët kishin besim te Hakiu, kurse Hakiu s'kishte besim në veten e tij. Atij ju mbush balli me djersë.

— Mirë, — tha Patriu — nesër përsëri do të shohim, po ti mos u mërzit, Haki, se kështu e kanë këto punë. — Hakiu nuk ishte i qetë.

Afërdita ju afrua pranë, ndjeu frymëmarrjen e thellë të tij dhe lëvizjen e flegrave të hundës. Hakiu përsëri s'e vuri re; ai lëvizi mekanikisht dhe bëri të dilte nga reparti. Maqina mbeti atje, ndërsa Hakiu, i zbetë, u nis. Prova e kopiatrices e kishte lodhur. «Nuk mundem» tha me vetë. «Do heq dorë», murmuriti i dëshpëruar; pastaj i hipi autobuzit dhe shkoi te pallati i kulturës. U ul në karrigën e butë, shtriu

trupin, por s'u kënaq aspak kur piu gotën me konjak, piu dhe një gotë tjetër me qëllim që ta harronte brengën që i solli dështimi i provës. Tek rrinte në vetëmi, ulur në anën e tryezës, vështronte nga dritarja poshtë rrugën ku kalonin njerëzit. Njerëzit ecnin të qetë, duke folur me shoqi-shoqin nën shkëlqimin e dritave neon. U kthye përsëri në pozicionin e mëparshëm, thirri kamerierin, pagoi dhe doli.

* * *

U zgjua duke gulçuar pasi kishte parë ëndrra të këqia. Ishte mbytur në djersë, me zor mbushej me frymë. Qëndroi ndenjur në shtrat derisa u qetësua. Ndezi dritën e vogël dhe vështroi orën. Ishte herët, prandaj shoi dritën përsëri, por nuk e zuri më gjumi, sado që u përpoq të flinte duke u kthyer sa në njërin krah në tjetrin. Mbyllte sytë, mendohej të largonte mendimet, por më kot: mendimet i turreshin më keq. I mërzitur, largoi jorganin mënjanë e, duke fërkuar sytë, hodhi këmbët në dysheme.

Kur po ecte rrugës, sikur filloi t'i pushonte dhe mbja e kokës dhe sikur po i freskoheshin mendimet. Nisi të arësyetonte më kthjellët. «Jo, tha, unë nuk heq dorë». Vrapoi me të shpejtë dhe hipi në autobusin e parë; kur arriti para klubit, zbriti, se e dinte që xha Petraqi e hapte shpejt kafenenë... Hyri brenda.

— Mirë mëngjez, xha Petro!

— Mirë se vjen, o djalë i mbarë! Ç'qenke ngri-tur kaq shpejt sot! — i tha bufetieri.

— U ngrita herët, s'më flihej, or xha Petro!

Petrua i zgjati mbi banak filxhanin me kafe.

— Na mbush nga një konjak! — i tha Hakiu.

— Me një nuse, Haki, dhe hë tani, shkripe! S'ke ç'pret më, apo jo, si thua?

— Ke të drejtë, xha Petro, bile më ka kaluar mosha, po ta marrësh shtruar.

— Hë, të shkretën, ma bëre qejfin. — Ata i kthyen gotat dhe xha Petroja mbushi dy gota të tjera konjak, nga ana e tij.

— S'të kam qerasur ndonjëherë. Ku ta dish? Unë sot jam, nesër s'jam. Më thanë të dal në pension, por nuk desha. Jam me ju, o bir, ç'të bëj me plakën në shtëpi, të zihemi tani në pleqëri? — Hakiu qeshi me sinqëritetin e Petros plak.

Autobusi i dytë solli punëtorë të tjerë. Hakiu doli nga klubi dhe menjëherë shkoi te kopiatricja, i hoqi kasetat dhe i vështroi duke i prekur lehtë me gishtërinj, si të kishte frikë se mos i lëndonte. Në atë çast ja behën punëtorët, që u afruan te Hakiu dhe pasi i thanë «mirë mëngjez», nisën të bisedonin për maqinën e tij. Hakiu u çudit me shokët, të cilët dukej sikur kishin fjetur me idenë e maqinës tërë natën. Tani po çuditej me veten e tij, si kishte bërë pa u konsultuar me shokët për punën që kishte nisur.

Sekretari i partisë i gjeti punëtorët duke biseduar me Hakiun.

— Haki, mbrëmë ike i dëshpëruar se nuk pate rezultat. Kështu më thanë shokët apo jo, Fatri? — i tha sekretari buzagaz.

— Kështu ishte, shoku Viron, ika shumë i dëshpëruar.

— Mos e ndërpre punën! — i tha Vironi dhe

i rrahu shpatullat siç e kishte zakon. Hakiu u ngroh dhe i ndritën sytë.

— Jo, i tha Hakiu, punën s'do ta ndërpres dhe pengesën që më doli do ta kapërcej me shokët!

— Këtë desha nga ti, që të kesh besim dhe të mos dëshpërohesh. — Hakiu mbloodhi grushtat, u mat të fliste, por s'mundi. Vironi, si i rrahu edhe një herë shpatullat, u largua, ndërsa Hakiu e ndoqi atë me vështrim derisa doli jashtë. Pastaj u bashkua me Fatriun, Sokratin dhe nisi të rrihte mendimet me ta.

— E di, Haki, unë dhe Sokrati mendojmë se maqinës sate i mungon një vegël që të shtyjë thikat, e kupton. Thikat e tua nuk largohen nga kallëpet, prandaj ne mendojmë që duhet një thikë tjetër që të mos presë, vetëm që të bëjë një rrugë sipas kallëpit origjinal. Kështu thikat do të punojnë si duhet.

Hakiu e kuptoi se shokët kishin menduar gjatë për çështjen e kopiatrices dhe ndjeu një dashuri të madhe për ta. Ai filloi nga puna, por vazhdimisht mendonte propozimin që i bënë shokët.

Kaloi një farë kohe. Hakiu po bindej se mendimi i shokëve duhej të ishte me vend.

Dita kundronte Hakiun që ishte zhytur në punë. Deshte që t'i shkonte pranë e t'i fliste. «Po pres derisa të bëjë provën e fundit, atëhere do t'i flas», mendoj ajo.

Në orën shtatë po bëheshin përpjekjet e fundit. Maqina mori pamje tjetër; ajo kishte tani një vegël më shumë. Hakiu përsëri e mbuloi fytyrën me pëllëmbët e tij të mëdha. Bulëza djerse i kishin mbuluar ballin; i mbetën vijëza të zeza në fytyrë. Thikat afroheshin me qetësi dhe nisën të punonin: atij i

bëhej sikur nuk shikonte më. Djersët i binin çurk mbi sy. Kallëpi rrotullohej e merrte formë, kurse rreth Hakiut filluan të mblidheshin punëtorët. Pak më vonë sikur u çlirua nga tensioni, i pa dhe u hodhi duart në qafë.

Dita mbeti prapa, s'kishte forcë të futej në mes tyre. «Të gëzojnë shokët, pa unë pres» tha ajo me vete dhe iku.

— Fatriu rrotulloi çelësin dhe nga kopiatricja nxori një palë kallëpe të punuara, që ja lëshoi Hakiut në duar.

— Merri. Haki, e shikoi. Kjo punë mbaroi!

Hakiu s'po u besonte syve. I dukej sikur ishte në ëndërr. U hodhi një vështrim shokëve dhe midis tyre vuri re Zenelin që i buzëqeshte.

«Po Dita, ku është Dita që nuk e shikoj në repart?.. Ah, paska ikur, sonte që desha t'i them diçka... ajo paska ikur! Sa keq!..»

Kur po ecte anës së rrugës dalloj një hije, mbështetur te trungu i një akacjeje. Hieja lëvizti dhe ai dalloj Afërditën që po i buzëqeshte...